

## Mbi

### Auditimin e Brendshëm

#### Ushtruar në Drejtorine Ekonomike e Arsimit

Njësia e Auditimit Brendshëm – Bashkia Shkodër bazuar në ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”, VKM nr 212 datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, zhvilloi një mision auditimi të plotë në Drejtorinë Ekonomike e Arsimit – Bashkia Shkodër, për periudhën 01 .01.2015 – 31.12.2017 nga auditimi rezultoi:

#### Përmbledhje ekzekutive

Drejtoria Ekonomike e Arsimit - Bashkia Shkodër funksionon si institucion varësie i Bashkisë, me varesi hirarkike nga Drejtoria Shërbimeve Sociale, Arsimit, Kultures,Sporteve,Gruas.

Për vitin **2015** Zyra Arsimit si veprimtari kryesore ka patur planifikimin dhe detajimin e shpenzimeve për institucionet e arsimit baze dhe QKF,janë trajtuar këto institucione arsimore :Shkolla të mesme të arsimit të përgjithshëm -3,shkolla të mesme profesionale -7, shkolla 9vjeçare -19, arsim parashkollor 10 kopshte pa drek dhe 5 kopshte me drekë,konvikte të shkollave të mesme -3, dhe qendra kulturore fëmijeve.

Për vitin **2016** drejtoria Ekonomike e Arsimit , me ndarjen e re territoriale ,mbështetur në VKB nr 17 datë 28.04.2016”Miratimi i buxhetit”, Bashkia mbulon “mirëmbajtjen e institucione arsimore për 11 njësite administrative”,konkretishte :64 shkolla,55 kopshte,3 konvikte.Për këtë vit risi ishte delegimi i funksioneve te reja si Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve, Punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (Parashkollor dhe të Qendres Kulturore), punonjësit e shërbimeve mbështetëse te Arsimit te Mesëm.

Per vitin **2017** drejtoria Ekonomike e Arsimit ,mbështetur në VKB nr.8 datë 30.01.2017 “Miratimi i buxhetit”,Bashkia siguron mirëmbajtjen e institucioneve arsimore në 11 njësi administrative,konkretishte: 107 shkolla, 60 kopshte, 2 konvikte,1 shkolle “Speciale”. Pjese e programit financiar është dhe delegimi i funksioneve te reja si: Arsimi parashkollor (kopshtet e fëmijëve), edukatorë dhe punonjës në Qendrat Kulturore të Fëmijëve, Punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin bazë, arsimin 9-vjeçar (Parashkollor dhe të Qendrës Kulturore), punonjësit e shërbimeve mbështetëse te Arsimit te Mesëm.

Drejtoria Ekonomike e Arsimit ka një **strukturë organizative** të qëndrueshme por të ndryshuar me reformen territoriale,krijimin e bashkisë së re ,si dhe ndryshimit te varësive te kopshte-çerdheve-konvikteve.

Gjatë auditimit janë konstatuar mangësi në përpilimin e rregullores brendshme dhe miratimin e saj, nuk janë hartuar plane vjetore, nuk është përpiluar harta e proceseve punës, nuk ka pershkrime pune,ka mangësi në përpilimin e regjistrit të riskut, nuk është bërë plani veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk janë përpiluar liste kontrollet për vizitat në tërren.

## **GJETJET DHE REKOMANDIMET**

**1.Gjetje** Referuar neneve 4, 5,11 të ligjit nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar,Anekseve të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdhërin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016, Drejtoria e Ekonomike e Arsimit - Bashkia Shkodër, duhej të kishte hartuar dhe miratuar rregulloren e brendshme të funksionimit, përgatitjen e planit vjetor të punës, përpilimin e hartës proceseve të punës, hartimin e regjistrit të riskut, planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, metodologjine dhe liste kontrollet për vizitat në tërren, planin kontrollit brendshëm, nga auditimi i kryer ka rezultuar se ka mangësi në përpilimin e rregullores brendshme dhe miratimin e saj, nuk janë hartuar plane vjetore, nuk është përpiluar harta e proceseve punës, ka mangësi në përpilimin e regjistrit të riskut, nuk është hartuar plani veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk janë përpiluar liste kontrollet për vizitat në tërren.

### **Rekomandime**

**a.** Përshtatjen dhe miratimin e rregullores së funksionimit në përputhje me shembullin 01 të manualit menaxhimit financiar dhe kontrollit, miratuar me urdhërin e Ministrit Financave nr. 108 datë 17.11.2016.

**b.** Përpilimin e planit vjetor të punës, përmirësimin e regjistrit të riskut, hartimin e planit veprimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, përpilimin e listave kontrolle për vizitat në tërren.

**2.Gjetje** Referuar germa “b” pika 4 neni 9 i ligjit 10296 date 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” drejtimi duhej të përcaktojë objektivat, në përputhje me objektivat e miratuara nga Titullari i Njësise Publike, për kryerjen e funksioneve të ngarkuara, në rritjen e efektivitetit të aktiviteteve të drejtorisë.

**3.Gjetje** Referuar neneve 23 e 24 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Drejtoria Ekonomike e Arsimit duhej të kishte ngritur sistemin e monitorimit, por nga auditimi rezultoi se kjo drejtori nuk ka ngritur sistemin e monitorimit.

### **Rekomandime**

**a.** Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të informimit dhe monitorimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e efikasitetit të institucioneve arsimore.

**b.** Të bëhet analiza e realizimit të objektivave të informohet me shkrim Drejtoria Kulture, Arsim, Rini e Sporte, si dhe Kryetare e Bashkisë lidhur me aktivitetin e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit.

**4.Gjetje.** Në referencë të pikës 263, të udhëzimit Nr.02 DT.06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” duhej të ishte përpiluar dhe miratuar gjurma e auditit për zbatimin e buxhetit, për zbatimin e buxhetit nuk është bërë përpilimi dhe miratimi i gjurmës së auditit.

**Rekomandim** Te kërkohet me shkrim, pranë Drejtorisë Planifikimit buxhetit në Bashki për të marrë asistencën e nevojshme për përpilimin e zbatimit të gjurmës së auditit për buxhetin.

**5.Gjetje** Në referencë të pikës 2 neni 7 Nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” në fund të vitit ushtrimor duhej të ishte bërë kontabilizimi i debitorëve dhe kreditorëve sipas detyrimeve dhe pagesave në fakt, ndërsa nga auditimi rezultoi se debitorët për secilin vit nuk janë pasqyruar në pasqyrat financiare vjetore.

**Rekomandime** Të bëhet riveifikimi i të gjithë detyrimeve për vitet 2015-2017, si dhe të nxirren të gjithë detyrimet e prapambetura. Në fund të vitit ushtrimor të bëhet korigjimi në pasqyrat financiare sipas faktit me detyrime debitorë dhe kreditorë.

**6.Gjetje.** Referuar neni 12 të ligjit 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, neni 40 pikat 1 e 8 të VKM 914 datë 29.12.2014 “Rregullat prokurimit publik”, Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve, si dhe planifikon në fillim të vitit natyren, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen, si dhe në asnjë rast, procedura prokurimit me vlerë të vogël nuk duhet të përdoret si mundësi për të pjesëtuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat prokuruese.

**7.Gjetje.** Në të gjitha rastet e blerjeve është vepruar me protokoll të brendshëm të institucionit, jo rregullisht dhe nuk është vepruar, me protokoll të veçantë për urdhërat, proces verbalët, dokumentat e prokurimit dhe shkresat me të tretë, për prokurimet publike referuar pikës 19/ neni 4 ligjit 10296 datë 8.07.2010 “Menaxhimi Financiar”.

**8.Gjetje.** “Kërkesat për prokurim” nuk janë përpiluar nga drejtuesi funksional i institucionit si dhe nuk i është drejtuar nëpunësit autorizues, veprim që bie në kundërshtim me nenet 140-142 Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr 02 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”. Drejtuesi i institucionit duhet të sqarojë arsyen e kryerjes së shpenzimit, bashkëngjitur specifikimet e mallit ose të shërbimit.

**9.Gjetje.** Referuar neni 40 pikës 2 të VKM nr 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Në prokurim Komisioni vlersues i prokurimeve nuk përbehet nga specialistë sipas natyrës së blerjes, mungon juristi.

**10.Gjetje.** Referuar nenit 40 pikës 3 VKM nr 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ” për blerjet në menyre elektronike,ftesa për ofertë duhet ti drejtohet 5 operatorëve elektronik.

**11.Gjetje.** Referuar pikës 7 neni 40 i VKM nr nr. 914 dt. 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. fatura tatimore nuk është e nënshkruar nga antarët e komisionit vlerësimit .

**12.Gjetje.** Referuar ligjit nr. 9723 dt. 03.05.2007 “Për QKR”, i ndryshuar firma fituese nuk ka të përcaktur në ekstraktin e QKR si operator për kryerjen e punimeve sipas të dhënave të kushteve teknike të objektit te shpenzimit dhe preventivit.

**13.Gjetje.** Referuar pikës 19/neni 4 ligjit 10296 datë 8.07.2010‘Menaxhimit Financiar’ , i ndryshuar dhe Urdhërit nr 57 datë 12.06.2014 të Ministrit të Financave”Për gjurmën e auditit për blerjet me vlera të vogla”,ne asnjë rast nuk plotësohet gjurma auditit per blerjet.

### **Rekomandime**

**a.** Dokumentacioni i prokurimit publik (urdhërat )të regjistrohen ne protokoll te veçante të sekretarisë të drejtorisë.

**b.** Kërkesa per shpenzim të përpilohet nga subjekti shpenzues, me analizë shpenzimi,të dërgohet nepërmjet prokollit Drejtorisë për miratim shpenzimi.

**c.** Te bëhet trajnimi i komisionit të blerjeve të vogla nga specialistet e Njesise Prokurimit pranë Bashkisë.

**d.** Komisioni vlerësimit dhe Autoriteti Kontraktor të verifikojë me korrektësi objektin e punës të operatorit ekonomik fitues, sipas QKR-së.

**e.** Te përpilohet për çdo procedurë blerje “gjurma auditit”.

**14.Gjetje.** Në refencë te nenit 40 ligjit 107/2014 ‘Për planifikimin dhe rregullimin territorit’, leja ndërtimit duhej të ishte lëshuar në bazë të kalendarit të punimeve të miratuar nga autoriteti planifikimit dhe shtyrja afatit përfundimit punimeve të bëhej 1 herë dhe për nje periudhë jo më të gjatë se afati fillestar. Për të njëjtin objekt janë leshuar dy leje ndërtimi me të njëjtin numër dhe datë ,me afate te ndyshme ( 2 dhe 3 mujor) , me nënshkrim elektrokunik me data te ndryshme.

**15.Gjetje.** Në referencë të nenit 9 te ligjit 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, zbatuesi i punimeve duhej të kishte njoftuar inspektoriatin vendor të mbrojtjes së territorit përpara fillimit punimeve. Zbatuesi i punimeve te ndërtimit e ka njoftuar INVMTerritorit me datë 19.05.2017 , me 14 ditë vonesë dhe IMT ka leshuar lejen për fillim punimesh pa e shoqëruar me gjobe,në referencë te pikës 2 nenit 15 të këtij ligji.

Mbikqyrësi punimeve përpara fillimit punimeve duhej të kishte kontrolluar të gjithë dokumentacionin përfshirë dhe lejen për fillim punimesh të lëshuar nga IMT-ë.

**16.Gjetje.** Në referencë të neneve 5, 7 të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, projekti është përgjegjësi e projektuesit, mbikqyrësi punimeve duhej të kishte bërë verifikimet e projektit dhe nëse ka ndryshime në projekt duhej të kishte bërë njoftimin pranë IMT-së.

**17.Gjetje.** Në referencë të modelit nr 01 të vendimit nr 4 datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njehsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, neni 17 i Rregullores së Arkivit në Republikën e Shqipërisë ,për normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, pranimi i dokumenteve hyrëse duhej të ishte regjistruar në regjistrin e korrespondences me nr protokollit, me datë të marrjes së dokumentit, etj.. Dokumenti me i rëndësishëm i realizimit të investimit “njoftimi për perfundimin e punimeve në objekt” nuk është protokolluar.

**18.Gjetje.** Në referencë të nenit 11 të ligjit 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve ,zbatuesi i punimeve duhej të kishte depozituar në autoritetin përkatës të planifikimit , kontrollit dhe zhvillimit territorit,një relacion së bashku me dokumentacionin përkatës që rrjedhin nga detyrimet e nenit 9 të këtij ligji, të përpiluar në dy kopje ku njëra kopje i lihet Autoritetit të planifikimit , kontrollit dhe zhvillimit territorit dhe kopja tjetër merret nga mbikqyrësi punimeve pasi është konfirmuar për depozitim dhe i dërgohet investitorit për kolaudim. Këto veprime nuk janë përmbytur nga zbatuesi dhe mbikqyrësi punimeve dhe për mos kryerjen e këtyre veprimeve,duhej të ishte dhënë masa administrative ‘gjobë’ referuar pikës 2 të nenit 15 të këtij ligji.

**19.Gjetje.** Në referencë të nenit 12 të ligjit 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kolaudatori duhej të kishte paraqitur në dy kopje , proces verbalin e kolaudimit në autoritetin e planifikimit , kontrollit dhe zhvillimit territorit dhe pas regjistrimit një kopje i dërgohet investitorit, në rastin konkret drejtorise ekonomike të arsimit. Këto veprime nuk janë përmbytur nga kolaudatori dhe për mos kryerjen e këtyre veprimeve,duhej të ishte dhënë me masën administrative ‘gjobë’ referuar të nenit 12 të këtij ligji.

**20.Gjetje.** Referuar Urdhëri nr 57 datë 12.06.2014 “Gjurma e auditit për prokurimet” në dokumentacionin likuidues të prokurimit duhet të jetë e dokumentuar,e nënshkruar gjurma auditit.

**21.Gjetje.** Në referencë të nenit 40 të ligjit 107/2014 ‘Për planifikimin dhe rregullimin territorit’, leja e ndërtimit duhej të ishte lëshuar në bazë të kalendarit të punimeve të miratuar nga autoriteti i planifikimit dhe shtyrja afatit të përfundimit punimeve të bëhej 1 herë dhe për një periudhë jo më të gjatë se afati fillestar. Për objektin e shkollës Tringe Smaja nuk është kërkuar leje ndërtimi për këtë veprim mban përgjegjësi Drejtore e Drejtorisë Ekonomike e autorizuar e

cila nuk ka ndjekur procedurën e kërkuar nga neni 40 ligjit 107/2014, mbikqyrësi i punimeve ka lejuar fillimin e punimeve pa leje ndërtimi, dhe Inspektoriati vendor i mbrojtjes territorit nuk ka bërë kontrollin në terren dhe pezullimin e punimeve deri në marrjen e lejes .

**22.Gjetje.** Në referencë të neneve 5, 7 të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, projekti është përgjegjësi e projektuesit, mbikqyrësi punimeve duhet të kishte bërë verifikimet e projektit dhe nëse ka ndryshime në projekt duhet të kishte bërë njoftimin pranë IMT-së.

**23.Gjetje.** Në referencë të modelit nr 01 të vendimit nr 4 datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njehsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, neni 17 i Rregullores së Arkivit në Republikën e Shqipërisë ,për normat tekniko – profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, pranimi i dokumenteve hyrëse duhet të ishte regjistruar në regjistrin e korrespondencës me nr protokollit, me datë të marrjes së dokumentit, etj.. Dokumenti me i rëndësishëm i realizimit të investimit “njoftimi për përfundimin e punimeve në objekt” nuk është protokolluar, mqs nuk ka person të ngarkuar për mbajtjen e protokollit ngarkohet me përgjegjësi drejtorja e drejtorisë ekonomike.

**24.Gjetje.** Në referencë të nenit 11 të ligjit 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve ,zbatuesi i punimeve duhet të kishte depozituar në autoritetin përkatës të planifikimit , kontrollit dhe zhvillimit territorit,një relacion së bashku me dokumentacionin përkatës që rrjedhin nga detyrimet e nenit 9 të këtij ligji, të përpiluar në dy kopje ku njëra kopje i lihet autoritetit e planifikimit , kontrollit dhe zhvillimit territorit dhe kopja tjetër merret nga mbikqyrësi punimeve pasi është konfirmuar për depozitim dhe i dërgohet investitorit për kolaudim. Këto veprime nuk janë përmbytur nga zbatuesi dhe mbikqyrësi punimeve dhe për mos kryerjen e këtyre veprimeve,duhet të ishte dhënë masa administrative ‘gjobë’ referuar pikës 2 të nenit 15 të këtij ligji.

**25.Gjetje.** Në referencë të nenit 12 të ligjit 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kolaudatori duhet të kishte paraqitur në dy kopje , proces verbalin e kolaudimit në autoritetin e planifikimit , kontrollit dhe zhvillimit territorit dhe pas regjistrimit një kopje i dërgohet investitorit, në rastin konkret drejtorisë ekonomike të arsimit. Këto veprime nuk janë përmbytur nga kolaudatori dhe për mos kryerjen e këtyre veprimeve,duhet të ishte dhënë masa administrative ‘gjobë’ referuar te nenit 12 të këtij ligji.

**26.Gjetje.** Referuar Urdhëri nr 57 datë 12.06.2014 ”Gjurma e auditit për prokurimet” ,në të dy rastet ,në dokumentacionin likuidues të prokurimit duhet të jetë e dokumentuar,e nënshkruar gjurma auditit.

**Rekomandim** Të bashkëpunohet me Njesinë e Prokurimeve Publike për trajnimin e personelit në lidhje me procedurat që kryhen për investimet publike që nga përcaktimi i fondit limit deri në pajisjen me certifikatë përdorimi të objektit.

**27.Gjetje.** Në referencë të pikave 8-10 të udhëzimit NR. 3, DATË 15.2.2001 "Për Mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të Ndërtimit " periudha e garancisë për punimet zgjat deri në dy vjet nga data e aktit të kolaudimit të punimeve e cila përcaktohet dhe në kontratë,për shumën për garancitë e punimeve janë në ruajtje që nga viti 2005.

### **Rekomandime**

**a.** Për të gjitha investimet deri në dy vite të ngrihet komisioni për të bërë vlerësimin e gjendjes së investimeve ,dhe të vazhdohet me procedurat e likuidimit të garancisë së punimeve në bazë të vlerësimit të komisionit.

**b.** Drejtoria Ekonomike e Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të bëjë kërkesë pranë Prokurisë së rrethit Shkoder në lidhje me ecurinë hetimeve.

**28.Gjetje.** Në referencë të pikave 34-41 të udhëzimit nr .30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” hyrja e mallrave në magazine duhet të ishte dokumentuar me fletëhyrje të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre,dhe fletë-hyrja duhet të ishte lëshuar nga magazinieri pasi të ishte bërë më parë verifikimi fizik i mallit.

**29.Gjetje.** Në referencë të pikës 85 germa a,b të udhëzimit nr .30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”komisioni i inventarizimit ka përgjegjësi të bëjë verifikimin fizik të mallit si dhe bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës,për nga auditimi rezultoi që komisioni i inventarizimit ka bërë inventarizimin pa bërë verifikimin fizik të mallit pasi mallin e disponon në ruajtje firma kontraktuar.

### **Rekomandim**

Te bëhet marrja në dorëzim e gjithë sasisë së mbetur të lëndës drusore, nga Drejtoria Ekonomike Arsimore.

**30.Gjetje.** Në referencë të pikave 34-41 të udhëzimit nr .30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” hyrja e mallrave në magazine duhet të ishte dokumentuar me fletëhyrje të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre,dhe fletë-hyrja duhet të ishte lëshuar nga magazinieri pasi të ishte bërë më parë verifikimi fizik i mallit.Dalja e mallit nga magazina e Bashkisë për tek magazina e drejtorisë ekonomike të arsimit duhet të ishte shoqëruar me urdhërdorëzimi,fletëkërkesë si dhe plani i shpërndarjes.Lëvizja e mallit nga magazina e drejtorisë ekonomike të arsimit për tek konviktet për artikujt që hyjnë pjesë-pjesë në vendmbërritje duhet të ishte pasqyruar me dokumenta të përkohshme dhe fletëhyrja duhet të ishte plotësuar me mbërritjen e gjithë sasisë së mallit.Por nga verifikimi i mallrave në ruajtje,malli i bërë hyrje në magazinën qendrore nuk është shoqëruar me urdhër-dorëzimi,nuk është bërë hyrja fizike e mallit si tek magazina qendrore,ashtu dhe tek magazina e drejtorisë ekonomike të arsimit dhe tek

magazinat e konvikteve .Malli është lënë në ruajtje tek firma kontraktore dhe admininstrimi nuk është bërë nga pergjegjësi material.

**31.Gjetje.** Në referencë të pikes 85 germa a,b te udhëzimit nr .30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”komisioni i inventarizimit ka përgjegjësi të bëjë verifikimit fizik të mallit si dhe bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës,por nga auditimi rezultoi që komisioni i inventarizimit ka bërë inventarizmin pa bërë verifikimin fizik te mallit pasi mallin e disponon në ruajtje firma konraktuar.

**32.Gjetje.** Specialistja e Drejtorise Ekonomike Arsimore e ngarkuar për ndjekjen dhe rakordimin ndërmjet konvikteve dhe shkolles 3 dhjetori, bazuar në hyrjet- daljet, urdhër dorezimin, regjistrat e nxënësve që frekuentojnë konviktet dhe shkolles 3 dhjetori, kartelat e mallrave në magazinë duhej të kishte bërë rakordimin e levizjes së mallrave nga magazina ne konvikte e mensa . Nga auditimi i kryer rezultoj se ka mangësi ne gjendjen fizike të mallrave, mallrat nuk shoqerohen me urdhër dorezimi, ka mangësi në përpilimin e regjistrit të prezencës së nxenesve të përpiluara nga kujdestarët. Për moskryerjen e rakordimeve mban përgjegjësi Specialiste e ngarkuar për kontrollin e magazinës për mosperpilimin e regjistrit pjesmarrjes se nxënësve në konvikt mban pergjegjesi Pergjegjesi i konvikteve.

### **Rekomandime**

**a.** Sasi e mallit në ruajtje të bëhet hyrje në magazinën e Drejtorisë ekonomike arsimit , duke bërë diferencimin , hyrje të menjëhreshme për mallrat që mund të magazinohen pa u dëmtuar dhe për mallrat që mund të dëmtohen te lidhet kontratë për lëvrimin e tyre.

**b.** Te bëhet rakordim i plotë i lëvizjes së mallrave nga magazina në konvikte dhe më pas mallrat gjendje në magazinat e konvikteve dhe shkolles 3 Dhjetori të bëhen rihyrje në magazinën Drejtorisë ekonomike të arsimit.

**c.** Furnizimi i konvikteve dhe shkolles 3 Dhjetori të bëhet ditor, bazuar në urdhër dorëzimin e nëpunësit autorizuar sipas numrit të nxënësve që trajtohen me ushqim .

**Njësia Auditimit Brendshëm**

**Bashkia SHKODËR**



